


GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS SË GJAKOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



INFORMATË

PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN- 2023

Të nderuar anëtarë të kuvendit tashmë është viti i dytë që Kryesuesja e Kuvendit e ka në praktikën e punës që të ju informoj për punën e kuvendit, për kundër faktit që Kryesuesja nuk ka obligim ligjor për të raportuar rreth punës së Kuvendit, por për shkak të vullnetit të mirë dhe për hir të transparencës së Kryesueses në mënyrë që të keni të përmbledhur në një dokument të përbashkët për anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e komunës së Gjakovës për të gjitha aktivitetet e Kuvendit të komunës për periudhën 1 vjeçare.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta. Bazuar në planin e punës, është përmbushur dhe tejkaluar plani i punës për vitin 2023 në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale që parasheh mbajtjen e së paku dhjetë (10) mbledhje brenda vitit.

Gjatë vitit 2023 Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ka shqyrtuar gjithsej:

130 pika të rendit të ditës, i ka miratuar:

55 akte nga të cilat:

54 vendime dhe 1 rregullore (është miratuar një rregullore për anulimin e pikës 1.1 të nenit 10 të rregullores për taksa dhe tarifa).

Përgjatë vitit 2023, Kuvendi i Komunës së Gjakovës e ka tejkaluar planin e punës duke e përmbushur me trajtimin e pikave të rendit të ditës që nuk kanë qenë të planifikuara në planin e punës së Kuvendit për vitin 2023. Përveç çështjeve (temave) të rregullta të cilat janë trajtuar në kuvend, janë diskutuar edhe tema të tjera, përfshirë këtu edhe pikat të cilat për çështje teknike janë shtyrë për diskutim në mbledhjen e ardhshme, kështu duke e tejkaluar planifikimin për vitin 2023.

Një ndër vendimet më të rëndësishme të Kuvendit këtë vit ka qenë vendimi për Miratimin e Emblemës së re të Komunës së Gjakovës me mbështetjen unanime të anëtarëve të kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur një mbledhje solemne dhe një mbledhje të përbashkët me karakter ndërkombëtar me Këshillin Bashkiak të Shkodrës në Bashkinë e Shkodrës. Në mbledhjen e përbashkët me Këshillin Bashkiak të Shkodrës me 13 tetor 2023 (në Bashkinë e Shkodrës) është diskutuar mundësia e bashkëpunimit dhe jetësimit të marrëveshjes për bashkëpunim në mes të dy vendeve tona.

Të gjitha ftesat për takime, rendi i ditës, materialet për diskutim dhe më pas edhe vendimet e Kuvendit janë publikuar me kohë në faqen zyrtare të Komunës, të cilat kanë qenë dhe janë në dispozicion për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës. Gjithashtu, njoftimet për mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa, të Kuvendit, të komiteteve tjera dhe aktivitetet me rëndësi janë publikuar në rrjetet sociale si njoftim për qytetarët.

Në përputhje me kornizën ligjore mbi transparencën dhe llogaridhënien, mbledhjet e komiteteve dhe të Kuvendit janë bërë publike përmes mediave lokale (televizion) ndërsa mbledhjet e

kuvendit janë transmetuar drejtpërdrejt në televizion, në youtube dhe në faqen zyrtare të Komunës.

Nga viti 2022 Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ka themeluar gjithsej nëntë (9) Komitete të ndryshme, të cilat kanë mbajtur takime për çështje të ndryshme të natyrës së punës së tyre.

Komitetet e Përhershme:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta.
2. Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta.

Komitetet Konsultative:

1. Komiteti për Arsim i ka mbajtur gjithsejtë 5 mbledhje.
2. Komiteti për Shëndetësi i ka mbajtur gjithsejtë 4 mbledhje.
3. Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara i ka mbajtur gjithsejtë 3 mbledhje.

Komitete të tjera që janë vlerësuar si të nevojshme nga Komuna:

1. Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për riemërtimin e rrugëve ka mbajtur 4 takime
2. Komiteti për Barazi Gjinore ka mbajtur 2 mbledhje, 1 mbledhje ka dështuar në mungesë të kuorumit.
3. Komiteti për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturore ka mbajtur 2 mbledhje, 2 mbledhje kanë dështuar në mungesë të kuorumit.
4. Forumi për transparencë Komunale ka mbajtur 4 takime.
5. Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur 1 mbledhje.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për riemërtimin e rrugëve i ka mbajtur gjithsejtë katër (4) takime, ku edhe i ka shqyrtuar të gjitha lëndët e drejtuara për shqyrtim dhe ju ka kthyer përgjigjeje në bazë të legjislacionit në fuqi.

Karshi obligimeve ligjore, Kuvendi në bashkëpunim me drejtorin komunale për buxhet dhe financa ka organizuar dy (2) dëgjime buxhetore me publikun për të prezantuar projekt buxhetin komunal për vitin 2024 dhe për të marr propozimet e tyre.

Në vitin 2023 Kuvendi në bashkëpunim me përfaqësues të NDI-USAID ka themeluar **Forum in e Transparencës**. Ky forum i krijuar për herë të parë në Komunën e Gjakovës ka pas për qëllim gjithë përfshirjen: Legjislativi, ekzekutivi, shoqëria civile, mediat. Forumi i transparencës në bashkëpunim me partnerët e Komunës së Gjakovës ka për qëllim përgatitjen e aplikimit për anëtarësim të Komunës së Gjakovës në Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP). Forumi është miratuar në Kuvendin e Komunës së Gjakovës me datë 27.07.2023. Në kuadër të aktiviteteve të këtij forumi janë organizuar dhe mbajtur katër takime të cilat kanë pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të këtij forumi, aktivitete këto që janë mbështetur nga NDI dhe USAID. Jemi në proces të anëtarësimit të Komunës së Gjakovës në OGP (Partneriteti për qeverisje të hapur) - organizatë ndërkombëtare për transparencë dhe llogaridhënie në nivel lokal.

Kuvendi i Komunës si dokument të rëndësishëm dhe i pari në nivel lokal ka miratuar edhe planin lokal të veprimit për barazi gjinore.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna e Gjakovës, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mos diskriminimi dhe fuqizimi i grave.

- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

*PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave Asambleiste, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Gjakovës, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjakovës, ka mbështetur përpjekjet e Zyrës Komunale për Barazi Gjinore në hartimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore. Përmes takimeve e në shërbim të planit, u përcaktuan fushat themelore strategjike dhe metodat për arritjen e barazisë gjinore në Komunën e Gjakovës. Në synim të promovimit dhe realizimit të integritit gjinor dhe barazisë, Komiteti për Politikë dhe Financa e pastaj edhe Kuvendi i Komunës shqyrtuan planin dhe miratuan me shumicë votash.

*Aktivitetet e Kryesueses së Kuvendit Komunal

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjakovës, në përputhje me Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale (LVL), neni 47.1, është konsultuar rregullisht me Kryetarin e Komunës gjatë përpilimit të pikave të rendit të ditës për mbledhjet e kuvendit, por edhe për çështjet tjera të rëndësishme të veçantë.

Kryesuesja gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar shumë takime zyrtare: takimet me qytetarë; takimet zyrtare me homologët e komunave tjera; takime me organizata ndërkombëtare; NDI, Fondacioni 'Jahjaga', OSBE, USAID, UN WOMEN, UBSHR. Kryesuesja e Kuvendit ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që është ftuar në nivel lokal dhe rajonal.

Bashkëpunimi është zgjeruar me grupin e grave përmes takimeve formale dhe jo-formale, me organizata të ndryshme të shoqërisë civile të komunës sonë, me mekanizmin kundër dhunës në familje, me kryetarët e këshillave lokal dhe shumë të tjera, të cilat më pas i kemi kanalizuar në vendim-marrje dhe adresuar tek ekzekutivi komunal.

Në fushën e rrjetëzimit, si Kryesuese kam bashkëpunuar dhe kam ofruar përvojat e mira të Kuvendit me komunat tjera të Kosovës dhe rajonit, përfshirë pjesëmarrjen me prezantime mbi promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe mënyrat e bashkëpunimit në kuvend, por gjithashtu edhe mënyrat e politikë-bërjes në lëmin e barazisë gjinore.

Kryesuesja e Kuvendit me kërkesën e tyre ka mbështetur grupin e grave pensioniste të Komunës së Gjakovës për nder të 8 Marsit (Dita e Gruas), në aspektin material dhe duke qenë prezent në organizimin e tyre.

Kryesuesja e Kuvendit ka iniciuar në bashkëpunim me Drejtoreshën e Arsimit znj. Eranda Kumnova- Baqi krijimin e korit të grave dhe vajzave të Komunës së Gjakovës, ku për këtë falënderoj të gjithë akterët kontribut dhënës.

Kryesuesja e Kuvendit tashmë për vitin e dytë me radhë në bashkëpunim me organizatën e të rinjve YMCA e ka shënuar në kalendarin e festave Ditën e Vajzave (11 Tetor).

Kryesuesja e Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka iniciuar organizimin e seancës solemne për nder të 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës (17 Shkurt). Në këtë seancë

solemne të ftuar për herë të parë kanë qenë delegacioni i komunitetit Arbëresh nga Italia dhe kryetarët e Komunave të Republikës së Shqipërisë me të cilat komuna tashmë kemi binjakëzim (Saranda dhe Shkodra).

Kryesuesja e Kuvendit ka iniciuar takimin e parë, duke bashkë vepruar me homologun e saj në Shkodër, për të mbajtur mbledhjen e parë sa formale dhe po aq domethënëse në mes të dy kuvendeve në nivel legjislativ.

Në kuadër të bashkëpunimit të komunave ndërkufitare të Republikës së Shqipërisë Kryesuesja e Kuvendit bashkë me Kryetarin e Komunës me ftesën e Kryetarit të Bashkisë së Hasit kanë realizuar një takim të përbashkët në kuadër të bashkëpunimit me komunat ndërkufitare për të vazhduar në vitin 2024 me komunat tjera ndërkufitare të Republikës së Shqipërisë dhe jo vetëm.

Kryesuesja e Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës kanë marrë iniciativën për organizimin e konferencës rajonale me temën “Roli aktual dhe e ardhmja e gruas në vendimmarrje fillon nga vetëqeverisja lokale” në Komunën e Gjakovës. Konferenca Rajonale në Komunën e Gjakovës është e para e këtij lloji dhe e këtyre përmasave në rrafshin e pjesëmarrësve dhe përfshirjes së shume personaliteteve.

Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference për gratë pikërisht në Gjakovë qëndron në faktin që në krye të Kuvendit është një grua, dhe kontributin e grave të komunës së Gjakovës në vendimmarrje në nivel të vendit.

Konferenca ka pasur karakter sensibilizues, informues, motivues.

Kryesuesja e kuvendit ka lobuar dhe ka kërkuar mbështetjen e kësaj konference rajonale nga të gjithë partnerët e komunës së Gjakovës dhe mbështetjen kryesore e ka pasur nga Organizata UN Women në Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal dhe Kryetari i Komunës të mbështetur nga UN Women në Kosovë organizuan **Konferencën Rajonale** për rolin e gruas në vendimmarrje “Roli aktual dhe i ardhshëm i gruas në vendimmarrje fillon nga vetëqeverisja lokale”. Konferenca ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të mësuar nga sukseset e qeverive lokale nga gratë vendimmarrëse që vijnë nga komunat tjera, për të identifikuar, shpërndarë dhe shkëmbyer format dhe funksionimin e sistemit vetëqeverisës lokal, me fokus respektimin e barazisë gjinore. Në fjalën hyrëse, znj. Arbëneshë Kuqi vlerësoi kontributin e pazëvendësueshëm të grave të suksesshme të Gjakovës nga e kaluara deri më sot në formësimin e së ardhmes, në promovimin e vlerave demokratike dhe në fuqizimin e përfshirjes së grave në vendimmarrje në mënyrë të barabartë në rolet kyçe. Mysafirë të veçantë dhe të dalluar ishin pjesë përbërëse e tre paneleve që prezantuan përvoja personale dhe profesionale, përfshirë diskutime mbi histori të suksesit, kapërcimin e sfidave, legjislacioni dhe politikat vendore. Diskutimet dhe përvojat ofruan kuptimin e sfidave dhe mënyrave për t'i kapërcyer ato, por gjithashtu inkurajuan pjesëmarrësit që në mënyrë aktive të fillojnë reformat në politikat për arsimin, fuqizimin ekonomik, medial dhe bashkëpunimin rajonal. Kjo ngjarje mbledhi në këtë event shumë delegacione siç është Presheva, Ulqini, Tetova, Saranda, Shkodra, Tirana dhe shumë panelistë, deputet, gra, personalitete publike në funksione të rëndësishme gjatë historisë qeverisëse të Republikës së Kosovës. Konferenca Rajonale “ prodhoi” rezultate të jashtëzakonshme në rrafshin e promovimit, rrjetëzimit, bashkëpunimit dhe përçoi mesazh të qartë që gratë duhet ta kenë hapësirën në vendimmarrje konform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës në nivel lokal dhe nacional.

Kjo konferencë ka filluar në Gjakovë, do të vazhdojë rrugëtimin në Komunat pjesëmarrëse dhe do të zgjerohet në përfshirje edhe të komunave tjera në nivel rajonal.

Kryesuesja e kuvendit i falënderon të gjithë kontribut dhënësit për organizmin e kësaj konference rajonale me jehonë ndërkombëtare.

***Sfidat e punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës:** në këtë periudhë janë shprehur një numër i rasteve ku anëtarësia e kuvendit të Komunës ka lëshuar mbledhjen në shenjë pakënaqësie rreth problemeve të caktuara. Në veçanti, mos qëndrimi në sallë i anëtarëve të Kuvendit gjatë punimeve të Kuvendit, por edhe vonesat, largimi i tërësishëm dhe mungesat paarsye janë vërejtur shpeshherë të cilat kanë shkaktuar edhe ndërprerjen e mbledhjeve për shkak të mungesës së Kuorumit.

Sfidë tjetër ishte mos-respektimi i rregullores së punës së Kuvendit, posaçërisht në rastet kur anëtarët flasin nga vendi pa lejen e Kryesueses, duke mos e respektuar rregulloren e cila është miratuar nga vet anëtarët e Kuvendit.

Duke marrë parasysh se MAPL është autoritet mbikëqyrës i komunave, komuna ka vepruar me përgjegjësi dhe me kohë sipas LVL-së në dërgimin e akteve të miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kuvendi ka rishqyrtuar 8 kërkesa me rekomandim nga autoritet qendrore.



Arbëresha Kuqi

Kryesuese e Kuvendit Komunal